



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1038/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Alberina Krasniqi kandidate për anëtarë të Asambles Komunale nga rradhët e Subjekti Politik Partia Demokratik e Kosovës PDK në Klinë, paraqitur kundër Qendrës së Numrimit të Rezultateve (QNR), për shkak të publikimit të rezultateve perfundimtare , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Alberina Krasniqi kandidate për Asamble Komunale nga rradhët e Subjekti Politik PDK dega Klinë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, në të cilën theksohet se në këto Qendra të Vendotimeve kam vrejtur se është bërë tjetërsim i votave , Gremnik QV-0816/01R, 0816C/02D, Shtupel QV-0814C/01R, 0814/02, 0814/03D, Gllarev 0808C/01R, 0808/02, QV-0808C/03R, 0808C/04D, Drenovc QV-0802C/01R ,QV-0802C/02R, QV-0802C/03D, Sferrkë QV-0803C/01R, QV-0803C/02R, QV-0803C/03R, QV-0803C/04R, QV-0803C/05D, Kpuz QV-0817C/01R QV-0817C/02D, Ujmir QV-0805C/01R, QV-0805C/02R, QV-0805C/03R, QV-0805C/04D, Jashanic QV-0807C/01R, QV-0807C/02R, QV-0807C/03R, QV-0807C/04D, Grabanic QV-0811C/01R, QV-0811C/02R, QV-0811C/03D.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të Alberina Krasniqi kandidate për Asamble Komunale nga subjektit politik (PDK), pretendohet se ka manipulim me vota të rezultatit perfundimtar , parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova më të cilën do të vertetohej se është kryer një veprim i tillë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 3.6 pika c, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja në Prishtinë**

A nr. 1038/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Ferit Osmani**



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*